MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër me objekt: "mbi procedurën e pranimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme" për periudhën 01/01/2010-31/12/2011" dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH nr. 80, datë 05/6/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01/6/2000, me shkresën nr. 147/12, datë 05/6/2012 dërguar **z. Neritan KALAMISHI,** regjistrues i ZVRPP Shkodër, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

Për Zonën Rurale.

Zona Kadastrale 3072.

1. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. 511, me sipërfaqe 2000 m^2 e regjistruar në vol. 3, faqe 84, në llojin e pasurisë "Arë" në pronësi të shtetasit [redacted], Z.K. nr. 3072.
Dokumentacioni (AMTP) duhet të dërgohet nga ZVRPP Shkodër, në Komisionin Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) i ngritur pranë Prefektures së Qarkut Shkodër, për shqyrtimin e vlefshmërisë së fitimit të titullit të pronësisë në bazë të "AMTP" për faktin se, mungon dokumentacioni ligjor që duhej të vinte me shkresë përcjellëse nga Këshilli i Qarkut Shkodër
Ky kufizim të zgjasë deri në realizimin e marrjes së vendimit të KV Shkodër për pavlefshmërinë ose vlefshmërinë e AMTP, por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

2. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. 1045/8 me sipërfaqe 24000 m^2 e regjistruar në vol. 8, faqe 39, në llojin e pasurisë "Are" në pronësi të Trashëgimtarët [redacted], Z. K. 3072 (Z. K. nr. 3734) Shkodër
Ky kufizim të zgjasë deri në momentin e miratimit nga Kryeregjistruesi, regjistrimin fillestar të pasurive "Në raste të veçanta" në zbatimin e Urdhrit nr. 61, datë 02.08.1999, të Kryeregjistruesit, por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

3. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. 623+1-3, Apartament me sipërfaqe 38 m^2 e regjistruar në vol. 9, faqe 55, në pronësi të [redacted] etj., Z.K. nr. 3072.
Ky kufizim të zgjasë deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit ligjor, por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

Zona Kadastrale 2702

1. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. 261/7, për diferencën me sipërfaqe prej 926 m^2, në llojin e pasurisë "Arë+Truall" dhe për pasurinë me sipërfaqe prej 176 m^2, "Ndërtesë" e regjistruar në vol. 5, faqe 161, në pronësi të shtetasit .[redacted], Z.K. 2702.
Ky kufizim të zgjasë deri në momentin e rregullimit të marrëdhënieve për diferencën prej 926 m^2, tokë "Arë+Truall" më shumë se sa ka dokumenti ligjor (AMTP nr. 201) dhe për sipërfaqen prej 176 m^2 "Ndërtesë", kjo e fundit deri në momentin e marrjes së lejes së legalizimit nga organet kompetente**.**

menjëherë

2. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. 153, për sipërfaqen prej 1030 m^2, në llojin e pasurisë "Truall" e regjistruar në vol. 2, faqe 246, (i ndryshuar) në llojin e pasurisë "Arë" në pronësi të shtetasit [redacted], ...Z. K. 2702.
Dokumentacioni (AMTP) duhet të dërgohet nga ZVRPP Shkodër, në Komisionin Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) i ngritur pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër, për shqyrtimin e vlefshmërisë së fitimit të titullit të pronësisë në bazë të "AMTP" për faktin se, pasuria e regjistruar është në llojin e pasurisë "Truall".
Ky kufizim të zgjasë deri në realizimin e marrjes së vendimit të KV Shkodër për pavlefshmërinë ose vlefshmërinë e AMTP, por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

3. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. 1/4, për sipërfaqen prej 5970 m^2, në llojin e pasurisë "Arë" e regjistruar në vol. 1, faqe 4, në pronësi të shtetasit [redacted], Z. K. 1466.
Dokumentacioni (AMTP) duhet të dërgohet nga ZVRPP Shkodër, në Komisionin Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) i ngritur pranë Prefekturës së Qarkut Shkodër, për shqyrtimin e vlefshmërisë së fitimit të titullit të pronësisë në bazë të "AMTP".
Ky kufizim të zgjasë deri në realizimin e marrjes së vendimit të KV Shkodër për pavlefshmërinë ose vlefshmërinë e AMTP, por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

4. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. 57/2, për sipërfaqen prej 500 m^2, në llojin e pasurisë "Vresht" e regjistruar në vol.1, faqe 34, në pronësi të shtetasit [redacted] Z.K.2702.
Ky kufizim të zgjasë deri në momentin e saktësimit të sipërfaqeve për pasurinë 57/3 dhe pasurinë 57/4 të pa pasqyruara në regjistrimin fillestar në HTR, (në hartën e punës) dhe çeljen e kartelave të reja në volum dhe faqe për këto dy pasuri, por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

5. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. nr. 385/65, për sipërfaqen prej 78 m^2, në llojin e pasurisë "truall dhe ndërtesë" e regjistruar në vol.1, faqe 203, në pronësi të [redacted], Z.K. 2702. (bazuar në Akt-Shitjen e apartamentit nga ish-Ndërmarrja Komunale-Banesave Shkodër).

Ky kufizim të zgjasë deri në momentin e rregullimit të marrëdhënieve me truallin, meqenëse NK. Banesave, është suprimuar të drejtat dhe detyrimet i kanë kaluar Zyrës së Strehimit dhe Shërbimit pranë Bashkisë Vau-Dejes, si për shitjen e banesave dhe të truallit funksional, por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

Zona Kadastrale 1329

1. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për sipërfaqet e përfituara tepër nga sa rezulton në dokumentin ligjor, për :

1.a. Pasurinë nr. 340/1 në llojit e pasurisë "Arë", regjistruar në vol.8, faqe 226 me sipërfaqe 7304 m^2 në pronësi të [redacted] **(**është përfituar më shumë se sa ka dokumenti ligjor (AMTP) një sipërfaqe prej 1354 m^2)

1.b. Pasurinë 389/63 në llojit e pasurisë "Pemë +Truall", regjistruar në vol. 4, faqe 172 me sipërfaqe gjithsej 687 m^2, nga këto "Truall" 300 m^2 dhe "Ndërtesë" 170 m^2, në pronësi të [redacted] **(**është përfituar më shumë se sa ka dokumenti ligjor (AMTP) një sipërfaqe prej 487m^2)

1.c. Pasurinë 392/10 në llojit e pasurisë "Pemë +Truall", regjistruar në vol.4, faqe 203 me sipërfaqe gjithsej 500 m^2, nga këto "Truall" 300 m^2 dhe "Ndërtesë" 85 m^2, në pronësi të [redacted] **(**është përfituar më shumë se sa ka dokumenti ligjor (AMTP) një sipërfaqe prej 300m^2).

Në të gjitha rastet e sipërcituara të veprohet si vijon, të mbyllet kartela e pasurisë "mëmë", duke çelur dy kartela të reja, njëra kartelë të regjistrohet sipërfaqja sipas dokumenti ligjor "Aktin e marrjes së tokës në pronësi" dhe në kartelën tjetër të regjistrohet diferenca e sipërfaqes së pasurisë që ngelet, në pronësi të "Shtetit", (në bazë të një plan-rilevimi të përgatitur nga top. me licencë dhe në bazë të një deklarate noteriale të kryefamiljarit)

Ky kufizim të zgjasë deri në realizimin dhe paraqitjen e plan-rilevimit dhe deklaratën noteriale të kryefamiljarit nga subjekti i interesuar, por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

Zona Kadastrale 1869

1. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për diferencën e sipërfaqen prej 1,107.8 m^2, në llojin e pasurisë "Truall" e regjistruar në vol. 7, faqe 176, në pronësi të shtetasit [redacted], Z.K. 1869, (bazuar në një kontratë shitblerje të pa regjistruar më parë në regjistrat e ZVRPP Shkodër).

Ky kufizim të zgjasë deri në momentit e rregullimit të marrëdhenjeve me truallin (blerjen e truallit në organet kompetente) por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

Zona Kadastrale 1076

1. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për arkëtimin e vleftës 15,534 lekë, në lidhje me regjistrimin kontratës shitblerjes nr.1103rep dhe nr.730 kol, datë 23.03.2009, për pasurinë nr. 219/37, në llojin e pasurisë "arë" e regjistruar në vol. 3, faqe 15, në pronësi të shtetasit[redacted], Z.K. 1076, (bazuar në një kontratë shitblerje të pa regjistruar më parë në regjistrat e ZVRPP Shkodër).

Ky kufizim të zgjasë deri në momentit e arkëtimin e vleftës 15,534 lekë por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

<u>Zona Kadastrale Urbane</u>

Zona Kadastrale nr. 8594

1. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. nr. 1/549, për sipërfaqen prej 68.85 m^2, në llojin e pasurisë "ndërtesë" e regjistruar në vol. 31, faqe 125, në pronësi të shtetasit [redacted], Z.K.8594. (bazuar në Vendimin e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Shkodër).

Ky kufizim të zgjasë deri në momentit e rregullimit të marrëdhënieve me truallin (blerjen e truallit në organet kompetente) por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

2. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. nr. 5/185, me sipërfaqe trualli 242 m^2 dhe sipërfaqe ndërtimi 84 m^2 e regjistruar në vol. 32, faqe 55, në pronësi të shtetasit [redacted] Z.K.8594. (bazuar në vendimin nr. 66, datë 15.04.2011 të Komisionit të regjistrimit sipas nenit 24/b të ligjit).

Ky kufizim të zgjasë deri në momentit e plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën "h" të nenit 193 te Kodit Civil, të nenit 24 dhe 38 të ligjit nr.7843 datë 1307.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar dhe të UKM nr. 1, datë 31.01.2007 "Për Procedurat e RPP", por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

3. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. nr. 5/101, me sipërfaqe trualli 262 m^2 dhe sipërfaqe ndërtimi 108 m^2 e regjistruar në vol. 32, faqe 209, në pronësi të shtetasit [redacted] Z.K.8594. (bazuar në Vendimin e Gjykatës Shkodër me nr. 31, datë 19.06.1997).

Ky kufizim të zgjasë deri në momentit e plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën "h" të nenit 193 te Kodit Civil, të nenit 24 dhe 38 të ligjit nr.7843 datë 1307.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajshme" i ndryshuar dhe të Udhëzimit të KM nr. 1, datë 31.01.2007 "Për Procedurat e RPP", por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

Zona Kadastrale nr. 8591

1. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika "b", të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për pasurinë nr. 18/727, në llojin e pasurisë "truall" me sipërfaqe 12.469 m^2 me referencë nr. 011529 regjistruar në vol. 46, faqe 55,
Z.K8591., në pronësi të shtetasit [redacted] (bazuar në Vendimin e Gjykatës Shkodër me nr. 1532, datë 05.06.2009).

Ky kufizim të zgjasë deri në momentit e plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën "h" të nenit 193 te Kodit Civil, të nenit 24 dhe 38 të ligjit nr.7843 datë 13.07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar dhe të UKM nr. 1, datë 31.01.2007 "Për Procedurat e RPP", por jo më shumë se 30 ditë.

menjëherë

Për të gjitha rastet e sipërcituara si për Zonat Rurale dhe ato Urbane me të cilat ju është rekomanduar nxjerrja e urdhër kufizimit, Regjistruesi në gjitha rastet duhet që Akti i kufizimit të lëshohet në formën e urdhrit, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të përmbajë mjetet mbrojtëse të palëve që u drejtohet, gjithashtu Regjistruesi duhet të njoftojë palët e interesuara brenda afatit ligjor, duke i orientuar subjektet për plotësimin dhe paraqitjen e dokumentacionit sipas rasteve në ZVRPP.

rast pas rasti

Nga KLSH

Të vihet në dijeni:
-Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për rezultatet e kontrollit të ushtruar në ZVRPP Shkodër në lidhje me shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të cilave do ju dërgohet nga një kopje e Raport Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimet për marrjen e masave disiplinore.

-Ministria e Drejtësisë, për rezultatet e kontrollit të ushtruar në ZVRPP Shkodër në lidhje me shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilave do ju dërgohet një kopje e rekomandimeve për marrjen e masës disiplinore.

B. **MASA DISIPLINORE**

A. Mbështetur në nenet 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:
"Vërejtje me paralajmërim" për:

1. [redacted] me detyrë Regjistrues i ZVRPP Shkodër.
Për moszbatim të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" me ndryshime, të Udhëzimit të KM nr. 1, datë 31.01.2007 "Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" dhe VKM nr. 1025, datë 09.07.2008, "Për Procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen", lidhur me:
a. Miratimin (me vendim) në bazë të nenit 24/b të ligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, pa pasur më parë Relacionin e përgatitur nga grupi i punës të konfirmuar nga i gjithë grupi për praktikat me numër reference 01176, 011268, 011113 dhe 011345 në Z. K. 8591 dhe për praktiken me numër reference 012668 në Z. K. 8594, në zbatim të VKM nr. 1025, datë 09.07.2008, "Për Procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen".
b. Konfirmimin e njëanshëm të procesverbalit të mbylljes të publikimit për shpalljen 45 ditore të pasurive me numër 3/900. 3/141, 6/651, dhe për pasurinë 7/41 në Z. K. 8591.
c. Mos refuzimin e pjesshëm në vendimin nr. 65, datë 15.09.2009, në vendimin nr. 16, datë 09.04.2010, në vendimin nr. 65, datë 15.09.2009 dhe të vendimin nr. 45, datë 28.09.2010 të Komisionit të regjistrimit sipas nenit 24/b të ligjit, ku diferenca tepër prej 18 m^2, 23 m^2, 18 m^2 dhe 27 m^2 "Truall" nuk justifikohet me dokument ligjor, për praktiken me numër reference 08907, Z. K. 8592 dhe për praktikat me numër reference 012079, 08907 dhe 012270 në Z. K. 8594, në zbatim të VKM nr. 1025, datë 09.07.2008,

“Për Procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen”,
d. Tejkalimin e kompetencave, duke lëshuar “Urdhër të brendshëm” për Fshirjen e shënimeve në radhorin nr. 825, datë 23.09.1999, nr. 347, datë 13.04.2000, nr. 566, datë 09.06.2000 dhe radhorin nr. 587, datë 14.06.2000”, Z. K. 8594, në mungesë të bazës ligjore apo nënligjore për të cilën i japin të drejtë Regjistruesit të ZVRPP-ve të kryejnë fshirje regjistrimi sepse me anë të Vendimit nr. 17, datë 23.04.2010, të Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është shfuqizuar si antikushtetuese, paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 10 të ligjit nr. 7843 datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar dhe UKM nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

2.[redacted], me detyrë Përgjegjës i Regjistrimit Fillestar dhe i Hartografisë.
Për moszbatim të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" me ndryshime, të Udhëzimit të KM nr. 1, datë 31.01.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe VKM nr. 1025, datë 09.07.2008, “Për Procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen”, lidhur me:
a. Mos paraqitjen e refuzimin të kërkesës për regjistrim Regjistruesit për praktiken me referencën nr. 012668 Z. K. 8594, ku në dokumentacion mungon origjina e pronës që të vërtetojë pronësinë mbi pasurin e pretenduar për regjistrim, sipas nenit 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të paluajtshme” i ndryshuar dhe sipas VKM nr. 1025, datë 09.07.2008, “Për Procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen”
b. Me fillimin e procedurës së regjistrimit fillestar të praktikes me referencën nr. 012921, Z. K. 8594, pa pasur më parë një vendim nga Kryeregjistruesit për miratimin ose refuzimin e Projekt-Urdhrit nr. 125, datë 02.09.2010 i Regjistruesit të ZVRPP Shkodër, në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 1, datë 31.01.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” .

3.[redacted] me detyrë specialist (jurist).
Për moszbatim të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" me ndryshime, dhe të Udhëzimit të KM nr. 1, datë 31.01.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” lidhur me:
a. Mos paraqitjen e një relacioni të detajuar regjistruesit në mënyrë kronologjike për gjithë origjinën e pronës bazuar në dokumentacionin e administruar në ZVRPP Shkodër, me referencë nr. 011529, regjistruar në vol. 46, faqe 55, Z. K. 8591, ku së bashku me dosjen e plotë të praktikës duhet ti drejtohej ZQRPP Tiranë për interpretim, në zbatim të UKM nr. 1, datë 31.01.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.
b. Fillimin e procedurës së rishqyrtimit të praktikës, sipas nenit 24/b të ligjit, për praktikën me referencën nr. 012353 pas fshirjes së shënimeve në radhorin nr. 825, datë 23.09.1999, nr. 347, datë 13.04.2000, nr. 566, datë 09.06.2000 dhe radhorin nr. 587, datë 14.06.2000”, Z.K. 8594, ku fshirja e regjistrimeve të kryera nga ana e regjistruesit ZVRPP Shkodër, nuk hyn më në juridiksionin administrativ, në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485 datë 12.5.1999 “Për Kodin e Procedurës Administrative”.

P.S. Për, [redacted] dhe [redacted] me detyrë ish-Regjistrues dhe për [redacted], [redacted] dhe [redacted] me detyrë ish-specialist nuk rekomandojmë marrjen e masave disiplinore për shkak se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër dhe për pasojë masa disiplinore ndaj tyre quhet e ezauruar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Qemal Meta, Seit Spahiu, Dorino Meço, Agim Mandri dhe Hekuran Avdulaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj dhe Drejtori Juridik dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT